



Në bazë të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28 e datës 04 qershor 2008, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1, nenit 7 paragrafi 1, nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1, nenit 14 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6 paragrafi 3, nenit 12 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.06/20, datë 05.08.2020), dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.05.2022, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë Vendim ipet në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik paluajtshmëria-prona komunale P-71409044-01952-1 në vendin e quajtur "Varosh" me sipërfaqe prej 30 m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 189 m² Zona Kadastrale Lipjan, e cila gjendet në rrugën "Shqipëria" përballë Stacionit të Policisë në Lipjan.

Neni 2

Sipas nenit 1 të këtij Vendimi prona komunale ipet në shfrytëzim afatshkurtër në afat prej 3 (tri) vitesh për ushtrimin e aktiviteteve biznesore, dhe çmimi fillestar do të jetë prej 2 € (dy euro) për m² nëpërmjet ankandit publik të përcaktuar sipas Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe e njëjta është publikuar brenda afatit ligjor në uebfaqen zyrtare të komunës sipas aktit të Zyrës së Kryetarit-Sektorit Pronëso-ro-Juridik 1Nr.463-60030 datë 30.09.2021 konform dispozitave të nenit 13 të Ligjit Nr.06/L-092 si prona të lira për dhënien në shfrytëzim.

Neni 3

Në pronën e cekur në nenin 1 të këtij vendimi nuk lejohet ndërtimi i objekteve të vrazhda apo të forta por vetëm i objekteve të përkohshme në pajtim me dispozitat e nenit 16 të Rregullores të Kuvendit të Komunës së Lipjanit 15Nr.011-5823 datë 01.02.2016 për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike.

Neni 4

Procedurën e ankandit publik e zbaton Komisioni Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal në bazë të Rregullores QRK Nr.09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektorit Pronëso- Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15 Nr. 463/02-28088

Lipjan, më 31.05.2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

